

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurës **M.B**, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, e akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5169/17, të dt.20.10.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më dt.**22.12.2017**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5169/17, të dt.20.10.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

E pandehura: M.B, e bija e B. dhe N, e gjinisë A, e lindur me dt..., në M, me vendbanim në P, në Rr. “S.K”, nr., me profesion piktore, e gjendjes së mesme ekonomike, e martuar, me nr. ID..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

S e p s e:

Me dt. 03.11.2016 rreth orës 14:00 në Prishtinë, në rrugën “S.V” e pandehura pas një mosmarrëveshje që kishte me të dëmtuarën-fqinjën, rreth një bodrumi, e kishte kanosur në atë mënyrë që i kishte thënë “se kam me të kall, ki me pa ti se kush jam unë, ki me pa çka ka me të gjetë, ti je një prostitutkë që të njuh krejt Kosova, sigurisht ke flet edhe me të gjykatës dhe qikën tende e ke shit për ti rregulluar punët tua, ki me pa qka ka me të gjetë ty, ti je aktore e podrumeve”, me ç’rast tek e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë ,-

- me këtë ka kryer veprën penale kanosje nga Neni 185 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Obligohet e pandehura që ti paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të jenë sipas llogaris së kësaj gjykate, dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara K.H nga P, me vendbanim në Rr. "S.V", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.5169/17, të dt.20.10.2017, e ka akuzuar **M.B**, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se e pandehura vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Kallëzimi penal, Raporti fillestar policor i dt.03.11.2016, deklaratat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, bazuar në të cilat shihet se ekziston dyshimi i arsyshëm se janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se e pandehura ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marr në bazë të nenit 450 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.4723/17, i dt.22.12.2017

Zyrtari Ligjor
Leutrim Hoti

Gjyqtarja,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.